

STATUTI

I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR “VA + NDREKAJ ENERGY & CONSTRUCTION GROUP ” SHPK.



Sot me 05.01.2018 2018, ne Tirane, ne te nenshkruarit,

- **Viktor PJETRI**, shtetas shqiptar, i datelindjes 10.03.1961, banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, Identifikuar me pasaporte shqiptare numer personal G10310401G ;
- **Vasil KALLUPI**, shtetas austriak, i datelindjes 01.01.1962, lindur ne Tirane dhe banues ne Viene, madhore dhe me zotesi juridike per te vepruar, me doukument identifikues karte identiteti austriake nr. DVR 0000191 dhe nr. 10890421, leshuar me date 16.04.2013 e vlefshme deri me date 15.04.2023 .

kemi themeluar një shoqëri me përgjegjësi te kufizuar sipas legjislacionit Shqiptar ne fuqi, dhe ne përputhje me kushtet e përcaktuara ne këtë Statut te Shoqërisë.

KREU I

EMERTIMI – SELIA – OBJEKTI - KOHEZGJATJA

Neni 1

Emërtimi

- Shoqëria është krijuar ne formën e një shoqërie me përgjegjësi te kufizuar. Emërtimi i shoqërisë është “ **VA + NDREKAJ ENERGY & CONSTRUCTION GROUP ” Shpk.** (ne vijim e quajtur “Shoqëria”). Shoqëria do te fitoje personalitet juridik pas regjistrimit te saj me Regjistrin Tregtar te mbajtur nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit.
- Shoqëria ushtron aktivitetin e saj ne përputhje me ligjin nr. 9901, date 14.04.2008 “Për Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare” (“Ligji Tregtar”), te ndryshuar, legjislacionin shqiptar ne fuqi, me këtë Statut dhe Aktin e Themelimit e Shoqërisë.

Neni 2

Selia

- Selia e Shoqërisë ndodhet ne adresën: Rruga “E Kavajes”, Pallatet “Sinani” ish Parku i autobuzeve Tirane, Shqipëri.
- Shoqëria mund te krijojë dege, zyra, filiale dhe te zhvillojë aktivitet ne vende te tjera, brenda ose jashtë territorit te Republikës se Shqipërisë me vendim te ortakeve te Shoqërisë.



Neni 3

Objekti i Shoqërisë

3.1 Shoqëria ka për objekt dhe qëllim të saj aktivitetet e mëposhtme:

- prodhim i energjis elektrike të gjitha llojeve (me uje fotovoltaike me ere etj).
- shitje blerje të energjise brenda dhe jashte vendit.

- Punime ndertimi rikonstruksioni dhe mirmbajtje të linjave ajrore dhe kabllore të tensionit ulet dhe të mesem. Punime ndertimimi dhe rikonstruksioni si dhe mirmbajtja e tyre i linjave dhe nestacioneve 35 kv, 110 kv ,220 kv dhe 400 kv .

- Punime civile industriale ndertimi dhe rikonstuksioni I godinave të banimit shume katshe shkollave spitaleve dhe gjithë insutucioneve të tjera shtetore, brenda dhe jashte vendit.

- Prodhimi shitja blerja dhe transporti i lendes drusore i bimve medicionale i prodhimeve farmaceutike paisjeve të shkollave spitaleve dhe i gjithë insutucioneve të tjera shtetore sistemeve të kondisionimit të ngrohjes paisjeve elektronike të ajtis. sistemeve të siguris brenda dhe jashte vendit.

- Punime të infrastruktures rrugore urave tuneleve kaskadave mureve tombinave perfshire të gjithë veprat e artit. punime të ujsjellsave kanalizimeve imjanteve të pastimit si dhe mirmbajtjen e tyre brenda dhe jashte vendit.

- Punime Ndertimi bujqesore , Prodhime dhe Tregitime bujqesore.

- Punime hidraulike, blerje, shitje materjale hidraulike

- Sherbime konsulence dhe projektimi i gjithë veprimtaris se permendur me lartte si edhe në fusha të ndryshme brenda dhe jashte vendit.

3.2 Me qëllim realizimin e objektit të aktivitetit të saj, Shoqëria mund të kryejë çdo veprimtari të nevojshme e të dobishme, të lejuar nga ligji për realizimin e objektit të aktivitetit të saj.

3.3 Shoqëria do të kryejë cdo lloj aktiviteti në raport me objektin dhe për të favorizuar atë. Shoqëria zbaton të gjitha ligjet dhe aktet nenligjore të duhura.

Neni 4

Kohëzgjatja


- Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj për një kohëzgjatje 20 vite duke filluar nga momenti i regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar të Republikës së Shqipërisë.
- Prishja dhe likuidimi i Shoqërisë do të përcaktohet me vendim të asamblesë së ortakeve në përputhje me dispozitat e këtij Statuti dhe legjislacionin në fuqi.

KREU II

KAPITALI

Neni 5

Kapitali

- 
- Kapitali themeltar i Shoqërisë është 100,00 Leke (Njëqind Leke), i perbere nga 2(dy) kuota me vlere nominale 1 kuote 50 ,00 Leke (pesedhjete leke). Kapitali themeltar është tërësisht i nënshkruar dhe shlyer.
 - Kapitali i Shoqërisë apo çdo kontribut ne para për zmadhimin e kapitalit paguhet ne llogarinë bankare te Shoqërisë.
 - Kuotat janë te transferueshme sipas kushteve te përcaktuara ne Ligjin Tregtar dhe ne këtë Statut.
 - Përgjegjësia e ortakeve shtrihet deri ne vlerën e kontributit te tyre ne kapitalin e Shoqërisë.
 -

Neni 6

Ortaket

Ortaket e Shoqërisë janë si vijon:

- **Viktor Pjetri** i cili me cilesine e Ortakut te Shoqerise dhe zoterues i 1(nje) Kuote, me vlere nominale 50,00 leke (pesedhjete) qe përfaqësojnë 50 % (Pesedhjete), te kapitalit te Shoqërisë;
- **Vasil Kallupi** i cili me cilesine e Ortakut te Shoqerise dhe zoterues i 1(nje) Kuote, me vlere nominale 50,00 leke (pesedhjete) qe përfaqësojnë 50 % (Pesedhjete), te kapitalit te Shoqërisë;
- Adresa e ortakeve për efekt te marrëdhënieve te tyre me Shoqërinë, është ajo qe rezulton nga regjistri i ortakeve. Është detyrim i ortakeve te njoftojnë ndryshimin e adresës se tyre. Administratori ka për detyre te mbaje dhe përditësoje këtë regjistër.

Neni 7

Kontributet dhe Financimet

- Kontributi i ortakeve ne kapitalin e Shoqërisë mund te jete ne para ose ne natyre, si pasuri te luajtshme, te paluajtshme apo te drejta.
- Shoqëria, me kërkesë te Administratorit dhe ne përputhje me dispozitat ligjore ne fuqi, mund te grumbulloje financime nga ortaket, me te drejte kthimi, jo detyrimisht ne përpjesëtim me kuotat e pjesëmarrjes te secilit ne kapitalin e Shoqërisë. Përveç kur parashikohet ne mënyrë specifike nga asambleja e përgjithshme e ortakeve, financimet e ortakeve ne favor te Shoqërisë do te konsiderohen pa qellim fitimi.

Neni 8

Transferimi i Kuotave

- 8.1 E drejta e Refuzimit te Pare. Nëse njeri nga Ortaket dëshiron t`i shesë, transferoje apo ne ndonjë mënyrë tjetër t`i disponoje ndonjë apo te gjitha kuotat e tij, (kjo pale do te quhet “Shitësi”), Ortaket e tjerë (“Pranuesi/t i Ofertës”) do te kenë te drejtën e përparësisë ne blerjen e këtyre kuotave (“Kuotat e ofertuar”) dhe do te zbatohen rregullat ne vijim:
- 8.1.1 Shitësi detyrohet te njoftoje me shkrim Pranuesin e Ofertës, për dëshirën apo qëllimin për t`i shitur te gjitha apo disa kuota te tij, një pale te trete. Ky njoftim duhet t`i kryhet me shkrim te Pranues/it/ve te Ofertës. Ky Njoftim (“Njoftimi i Shitjes”) duhet te përmbajë:

- (i) numrin e kuotave ne pronësi efektive te Shitësit;
- (ii) numrin e kuotave qe përbejnë Kuotat e Ofruara për shitje, çmimin dhe afatet e kushtet e shitjes se Kuotat te Ofruara për shitje;
- (iii) emrin e blerësit te propozuar;
- (iii) bashkëngjitur kopjen e nënshkruar te Letrës se Mirëkuptimit apo marrëveshjes ndërmjet Shitësit dhe Blerësit te propozuar.

8.1.2 Çdo Pranues i Ofertës brenda periudhës prej tridhjetë (30) ditëve nga dita kur Njoftimi i Shitjes do te mendohet se i është dhënë, mundet te njoftoje me shkrim Shitësin. Ky njoftim (“Njoftimi i Blerjes”) duhet te theksoje qarte se Pranuesi i Ofertës dëshiron apo nuk dëshiron t’i blejë Kuotat e Ofruara për Shitje. Nëse Pranuesi i Ofertës dështon ne dhënien e Njoftimit te Blerjes, ai do te konsiderohet se ka refuzuar t’i blejë Kuotat e Ofruara.

8.1.3 Pasi Shitësi te këtë marre te gjitha Njoftimet për Blerje te mundshme, apo pas kalimit te afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga data e Njoftimit te Shitjes, cilido qe është me i hershem, Shitësi detyrohet t’ia shesë te gjitha Kuotat e Ofruara për shitje, te Pranuesit/it/ve te Ofertës i cili/te çilet ne Njoftimin për Blerje ka/ne shfaqur dëshirën për blerjen e Kuotat te Ofruara për shitje (me poshtë do te quhen “Blerësit”) sipas çmimit dhe kushteve te përcaktuara ne Njoftimin e Shitjes.

8.1.4 Nëse me shume se një Pranues i Ofertës ka bere një Njoftim për Blerje drejtuar Shitësit duke shfaqur dëshirën e tij/saj për te blere Kuotat e Ofruara, atëherë, Blerësit do te blejnë te gjitha Kuotat duke përfshire Kuotat e Ofruara për Shitje, ne masën për te çilen është rene dakord midis tyre, ose, ne mungese te marrëveshjes, *Pro-rata* me kuotat e zotëruara nga secili Blerës duke mos i llogaritur kuotat e Shitësit.

8.1.5 Nëse Pranuesi/t e Ofertës, për shkak te arsyeve te parashikuara ne dispozitat e mësipërme, nuk i blejnë Kuotat e Ofruara për Shitje, atëherë Shitësi do te jete i lire t’ia shesë kuotat e ofruara për shitje, Blerësit te propozuar ne Njoftimin e Shitjes, por vetëm sipas çmimit i cilit është i njëjte apo me i madh se çmimi i përcaktuar ne Njoftimin e Shitjes dhe sipas kushteve te parashikuara ne Njoftimin e Shitjes apo kushteve me te favorshme për Shitësin, se sa ato te parashikuara ne Njoftimin e Shitjes. Nëse, brenda një qind e pesëdhjete (150) ditëve nga data e kalimit te afatit prej tridhjetë (30) ditëve, gjate te cilit te Ofertuari kane mundur t’i shfrytëzojnë te drejtat e tyre te përshkruara me lart, Shitësi nuk e ka përfunduar procesin e shitjes se Kuotave te Ofruara tek Blerësi i propozuar i treguar ne Njoftimin e Shitjes, atëherë te drejtat e Pranuesit te Ofertës lidhur me Kuotat e Ofruara për shitje do te ripërtërihen dhe nëse Shitësi edhe me tutje dëshiron te shesë ndonjë nga kuotat e tij, duhet te kryeje përsëri një Njoftim ne përputhje me paragrafin 8.1 te këtij Neni 8 dhe kështu me radhe here pas here.

8.16 Çdo oferte për shitjen e kuotave drejt një pale te trete duhet patjetër te përfshije kushtin qe pala e trete te bjere dakord qe te behet pale e këtij Statuti,si dhe e te gjitha marrëveshjeve te ortakeve te cilat janë ne fuqi para blerjes se kuotave.



8.2 Te Drejtat e Parablerjes. Dispozitat ne vijim do te zbatohen per kontributet e reja ne kapitalin e Shoqerise:

8.2.1 Nëse shoqëria propozon rritjen e kapitalit duke kërkuar kontribute te reja (“Kontributet e Reja”), Kontributet e Reja do t’u kerkohen te gjithë ortakeve. Shoqëria do t’i dërgoje një Njoftim me shkrim (“Njoftimi per Kontribute”) secilit ortak.

8.2.2 Çdo ortak i cili dëshiron te paguaje per nje pjese ose per gjithe Kontributet e Reja, duhet ta njoftoje me shkrim Shoqërinë.

8.2.3 Nëse ndonjëri nga ortaket pranon ofertën e përcaktuar ne Njoftimin per Kontribute, ortaku duhet te nënshkruaje Kontributet e Reja ne përputhje me Njoftimin per Kontribute dhe duhet menjëherë te nënshkruaje gjithashtu një pranim me shkrim i cili do te pranohet menjëherë nga shoqëria. Ortaket do te kenë te drejte te nënshkruajnë dhe shlyejnë Kontributet e Reja ne masën mbi te cilen ata kane rene dakord, ose ne mungese te një marrëveshje te tille, ne mënyrë proporcionale me numrin e kuotave qe zotëron secili ortak.

8.2.4 Çdo Kontribut i Ri i cili nuk është nënshkruar nga ortaket ne përputhje me paragrafin 8.2 te këtij Neni 8, mund t’i ofrohet një pale te trete te interesuar nga Shoqëria sipas çmimit dhe afateve te përcaktuara ne Njoftimin per Kontributet.

8.3 Kufizimet e Disponimit

8.3.1 Asnjë nga ortaket nuk mund te shesë, transferoje, disponoje, te dhuroje, ta lere hipoteke apo peng, ngarkoje me ndonjë barre tjetër (se bashku “Disponim”) kuotat tij pa miratimin paraprak te Ortakut tjetër. Çdo shitje, akordim transferim, disponim, dhurim, hipoteke, peng, apo ndonjë barre tjetër mbi kuotat, e vendosur pa miratimin paraprak te Ortakut tjetër, do te konsiderohet nul/e pavlefshme, dhe nuk do te krijojë efekte për Shoqërinë.

KREU III

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Neni 9

Asambleja e ortakeve dhe kompetencat e saj

- Ne baze te ligjeve dhe dispozitave te këtij Statuti, asambleja e përgjithshme e ortakeve te Shoqërisë është organi me i larte vendimmarrës i Shoqërisë. Ajo perfaqeson te gjithe ortaket dhe vendimet e saj, te marra ne perputhje me ligjin dhe kete Statut, jane detyruese per te gjithe ortaket, perfshire ata qe nuk marrin pjese ne votim dhe qe votojne kunder ketyre vendimeve.
- Vendimet per çeshtjet e meposhtme te Shoqerise mund te miratohen ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme te ortakeve ose nepermjet konsultimit me shkrim:
 - percaktimi i politikave tregtare te Shoqerise;
 - miratimi i ndryshimeve te Statutit;

- emerimi e shkarkimi i Administratorit si dhe percaktimi i kompetencave dhe shperblimit te tij;
- emerimi e shkarkimi i likuiduesve dhe eksperteve kontabel te autorizuar si dhe percaktimi i shperblimit te tyre;
- mbikeqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga Administratori, perfshire mbikeqyrjen e pergatitjes se pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;
- miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates dhe brenda gjashte muajsh nga perfundimi i vitit financiar;
- zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit te Shoqerise pas marrjes dhe shqyrtimit te dokumenteve perkates;
- pjesetimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- caktimin e perfaqesuesit te Shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj Administratorit;
- miratimin e riorganizimit te Shoqerise, perfshire bashkimin me shoqeri te tjera, ndarjen e Shoqerise, shnderrimin e Shoqerise si dhe prishjen e Shoqerise;
- miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese se ortakeve.

Neni 10

Perfaqesimi dhe Kuorumi

- Çdo ortak ka te drejte te marre pjese ne asamblene e pergjithshme dhe te votoje sipas kuotave qe zoteron ne kapitalin e nenshkruar e te shlyer te Shoqerise.
- Ortaket mund te perfaqesohen ne asamblene e pergjithshme nga nje ortak tjetër apo nje person i trete i autorizuar nepermjet prokures me shkrim.
- Pervec se kur parashikohet ndryshe nga Statuti, asambleja e pergjithshme e ortakeve vendos ne menyre te vlefshme kur ne mbledhje marrin pjese ortaket me te drejte vote qe perfaqesojne me shume se 50% (pesedhete perqind) te numrit total te votave dhe vendimet merren me votat pro te me shume se 50% (pesedhete perqind) te ortakeve te pranishem. Ky parashikim nuk do te zbatohet ne rastin e shkarkimit te Administratorit, rast ne te cilin asambleja e pergjithshme e ortakeve vendos ne menyre te vlefshme kur ne mbledhje marrin pjese ortaket me te drejte vote qe perfaqesojne me shume se 30% (tridhete) te numrit total te votave dhe vendimet merren me votat pro te me shume se 50% (pesedhete) te ortakeve te pranishem.
- Per te vendosur ndryshimin e Statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimit, riorganizimin ose prishjen e shoqerise, asambleja e pergjithshme e ortakeve konsiderohet e mbledhur rregullisht kur jane te pranishem ose te perfaqesuar ortaket qe zoterojne te pakten 75% (shtatedhete e pese perqind) te kapitalit te Shoqerise. Vendimi merret me voten pro te te pakten 75% (shtatedhete e pese) perqind te ortakeve te pranishem.
- Nese asambleja e pergjithshme nuk mund te vendose per shkak te mungeses se kuorumit te percaktuar me lart, ajo mblidhet perseri jo me vone se 30 (tridhete) dite, me te njejtin rend dite.

Neni 11

Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

- Asambleja e pergjithshme e ortakeve duhet te thirret te pakten nje here ne vit, brenda 6 (gjashte) muajve nga mbyllja e vitit financiar per miratimin e pasqyrave financiare dhe raportit te ecurise se veprimtarise te Shoqerise te hartuar nga Administratori, si dhe çdo here qe gjykohet e nevojshme nga Administratori, si dhe kur kjo kerkohet me shkrim nga nje ose disa ortake qe zoterojne te pakten 5% (pese perqind) te kapitalit te Shoqerise. Ne rastin e fundit nese Administratori nuk e therrret asamblene brenda 15 (pesembedhete) ditesh nga paraqitja e kerkeses se ortakeve te siperpermendur, keta te fundit kane te drejte ta therrresin vete asamblene e pergjithshme te ortakeve, duke percaktuar rendin e dites, kohen dhe vendin e takimit ne perputhje me procedurat e percaktuara ne dispozitat ne vijim.
- Gjithashtu asambleja e ortakeve thirret ne rastet kur:
 - sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 (tre) muajve ne vazhdim.
 - shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5% (pese perqind) te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
 - shoqeria, brenda 2 (dy) viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5% (pese perqind) te aseteve te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te certifikuara.
- Asambleja e pergjithshme e ortakeve mblidhet ne seline ligjore apo prane nje vendi tjeter brenda ose jashte Shqiperise.
- Mbledhja e asamblese se pergjithshme te ortakeve thirret me ane te nje njoftimi me shkrim te derguar me poste te regjistruar ose faks ose nepermjet postes elektronike qe i drejtohet secilit prej ortakeve. Njoftimi duhet te tregojë rendin e dites, vendin, daten dhe oren e mbledhjes dhe do t'i dergohet secilit ortak, jo me vone se 7 (shtate) dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese. Gjithashtu, njoftimi duhet te permbaje, edhe menyren e pjesemarrjes ne asamblene e ortakeve dhe/ose menyren e vendimmarrjes.
- Njoftimi i mbledhjes mund te parashikojë edhe nje date te dyte per mbledhjen e asamblese ne rast se mbledhja e pare nuk zhvillohet sipas njoftimit, ne perputhje me percaktimin ne nenin 10.5 te ketij Statuti.
- Ne rastin kur njoftimi i mbledhjes behet nepermjet postes elektronike (e-mail), njoftimi konsiderohet i marre nga ortaket ne daten/oren e shenuar ne mesazhin e marrjes/dorezimit te njoftimit te postes elektronike.
- Ne rastin kur njoftimi i mbledhjes behet me faks, njoftimi konsiderohet i marre nga ortaket ne date/oren e shenuar ne mesazhin e marrjes/dorezimit te gjeneruar nga pajisja e faksit.
- Mbledhjet e asamblese se pergjithshme te ortakeve dhe vendimet e saj jane te vlefshme, edhe pa thirrje formale, kur marrin pjese te gjithe ortaket qe perfaqesojne te gjithe kapitalin e Shoqerise.



- Asambleja e pergjithshme e ortakeve kryesohet nga personi i emeruar nga shumica e ortakeve pjesemarres (ne vijim i quajtur “Kryetari i Mbledhjes”).
- Kryetari i Mbledhjes emerohet sekretarin, i cili harton procesverbalin e mbledhjes se asamblese.
- Ortaket mund te marrin pjese ne mbledhjen e asamblese nepermjet mjeteve elektronike si telekonferenca, video-konferenca, apo komunimit video-shkrues.
- Perdorimi i mjeteve elektronike do te kryhet duke marre te gjitha masat teknike te nevojshme per garantimin e identifikimit te ortakeve, si edhe sigurine e ketyre mjeteve elektronike. Ne vecanti eshte e nevojshme qe:
 - Kryetari i Mbledhjes te kete mundesine te verifikoje dhe te identifikojte ortaket te cilet jane te pranishem, te kontrolloje mbarevajtjen e mbledhjes, te numeroje dhe te shpalle rezultatin e votimit;
 - Sekretari dhe/ose mbajtesi i procesverbalit te kete mundesine per t’u njohur me faktet dhe ngjarjet e ndodhura ne mbledhjen, objekt te procesverbalit;
 - Te mundesohet pjesemarrja e te gjitha te pranishmeve per te diskutuar mbi rendin e dites, ne shqyrtimin, marrjen dhe shperndarjen e te gjitha dokumentave te perdorura gjate mbledhjes si dhe ne procesin e votimit mbi rendin e dites.
- Mbledhja e asamblese ne kushtet e permendura ne nenin 11.11 dhe vijues te ketij Statuti, konsiderohet rregullisht e mbajtur ne vendin ku eshte i pranishem Kryetari i Mbledhjes, Sekretari ose mbajtesi i procesverbalit, i cili ben te mundur pergatitjen dhe mbajtjen e procesverbalit te mbledhjes.
- Kryetari i Mbledhjes do te verifikoje identitetin e çdo ortaku pjesemarres ose perfaqesuesve te tyre.
- Ne rast se ortaket jane te ftuar te marrin vendime nepermjet konsultimit me shkrim, kuorumi do te quhet si i formuar bazuar ne numrin e ortakeve qe do te dergojne votimin dhe vendimet e tyre me shkrim. Administratori ose ortaket e qe kerkojne vendimarrjen duhet t’i dergojne çdo ortaku njoftimin per konsultimin me shkrim, i cili do te permbaje gjitha informacionet qe perfsihen ne letren e njoftimit/thirrjes te percaktuar ne nenin 11.4 te ketij Statuti. Procedura e konsultimit me shkrim duhet te kryhet ne perputhje me permbajtjen e ketij neni, ne rastet kur zbatohet. Çdo ortak duhet te shprehet me shkrim ne lidhje me projekt-vendimet duke votuar mbi dokumentin e projekt vendimeve ne formen e derguar nga Administratori, nepermjet shenimit “pro” ose “kunder” ose duke u shprehur komentet e tyre ne nje dokument tjetër. Ne rast se ortaket kane komente, duhet t’u bejne reference te qarte projekt-vendimeve. Secili ortak duhet t’i dergoje Administratorit ose ortakeve qe kane kerkuar marrjen e vendimit nepermjet keshillimit me shkrim, voten e tij/vendimet me shkrim brenda dates se percaktuar ne njoftimin e derguar per marrjen e vendimin nepermjet konsultimit me shkrim.
- Vendimet e ortakeve te marra si dhe diskutimet dhe komentet e ortakeve duhet te pasqyrohen ne procesverbalin e mbledhjes te hartuar nga Sekretari i mbledhjes. Gjithashtu ky procesverbal duhet te pasqyroje menyren e organizimit te mbledhjes se asamblese apo te konsultimit me shkrim nese eshte kryer ne perputhje me ligjin dhe dipozitat e Statutit, te identifikojte ortaket e pranishem dhe te perfaqesuar ose ortaket qe kane votuar me shkrim, nese kuorumi i ortakeve qe kane votuar me shkrim eshte respektuar sipas Statutit dhe Ligjit Tregtar, si dhe nese vendimet konsiderohet te miratuara sipas

votave te marra. Procesverbali do te nenshkruhet nga Kryetari dhe Sekretari i mbledhjes. Procesverbalit i bashkengjitet gjithashtu lista e ortakeve qe kane votuar (pervec rastit kur procesverbali eshte nenshkruar nga gjithe ortaket) si dhe njoftimi i thirrjes se asamblese te cilat mbahen ne seline e Shoqerise. Nese vendimet e marra nga ortaket duhet te depozitohen prane Regjistrin Tregtar, procesverbali i mbledhjes dhe votat e dhena (nepermjet konsultimit me shkrim nga ortaket) do te sherbejne si dokumentet qe provojne te dhenat qe do te depozitohen ne kete regjister.

- Ne rast se asambleja e pergjithshme e ortakeve nuk mund te shqyrtoje ne te njejten dite te gjitha ceshtjet qe duhen diskutuar, vazhdimi i mbledhjes do te behet te nesermen pa pasur nevoje per njoftim te metejshem.

KREU IV

ADMINISTRIMI I SHOQERISE

Neni 12

Administrimi i Shoqerise

- Administrimi i Shoqerise do te kryhet nga Administratori i emeruar me shumice te thjeshte te votave ne asamblene e ortakeve.
- Administratori do te emerohet nga asambleja e ortakeve dhe mund te shkarkohet ne çdo kohe me vendim te asamblese se ortakeve.
- Administratori do te jete person fizik pa asnje kufizim per sa i perket kombesise se tij. Afati i emerimit i te Administratorit do te caktohet ne momentin e emerimit te tyre por ky afat nuk mund te jete me i gjate se 5 (pese) vjet. Pa cenuar kete kufizim afati i emerimit te tyre mund te ripërterihet me vendim te asamblese se ortakeve.
- Administratori do te rimbursohet per shpenzimet e kryera gjate ushtrimit te detyrave te tij. Asambleja e ortakeve mund te vendose te jape edhe shperblime vjetore.
- Ne rast doreheqje Administratori do te njoftoje me shkrim asamblene e ortakeve. Doreheqja do te hyje ne fuqi ne momentin e emerimit te Administratorit te ri.
- Administratori do te administroje veprimtarine e perditshme te Shoqerise ne perputhje me kete Statut dhe dhe legjislacionin e aplikueshem perkates.

Neni 13

Kompetencat e Administratorit

- Administratori i shoqerise eshte caktuar znj. **Marjela Tarja**, shtetase shqiptare, e datelindjes 17.07.1986, lindur dhe banuese ne Tirane, mbajtese e dokumentit personal te identifikimit Ppasaporte

nr. BJ1630352 dhe nr. Personal I5571713S, per nje afat 5 vjecar duke filluar ky afat me regjistrimin e shoqerise ne QKR Tirane.

- Administratori do te jete pergjegjes per administrimin e Shoqerise dhe do te perfaqesoje Shoqerine kundrejt paleve te treta ne perputhje me dispozitat e ketij Statuti dhe/ose te ligjit te zbatueshem. Administratori ka kompetenca te plota per te marre vendime te zakonshme dhe te jashtezakonshme per administrimin e Shoqerise, pervec kompetencave qe do te ushtrohen nga organe te tjera te Shoqerise sipas ketij Statuti ose ligjit te zbatueshem.
- Administratori do te kete keto kompetenca dhe detyra qe lidhen me administrimin dhe mbikeqyrjen e veprimtarise se Shoqerise si me poshte:
 - te mbikeqyre dhe te zbatoje politikat tregtare te Shoqerise dhe vendimet e asamblese se pergjithshme te ortakeve;
 - te siguroje qe Shoqeria respekton ligjin(et) e zbatueshem dhe standardet kontabel;
 - te kryeje te gjitha veprimet ne lidhje me administrimin e veprimtarise tregtare te Shoqerise, duke perfshire te gjitha transakcionet financiare te nevojshme te perfshira ne kuadrin e administrimit te veprimtarise tregtare.;
 - te perfaqesoje Shoqerine kundrejt paleve te treta;
 - te siguroje qe dokumentet dhe librat kontabel te Shoqerise te mbahen rregullisht;
 - te therrase mbledhjet e asamblese se pergjithshme te ortakeve, nese e vlereson te nevojshme per mbrojtjen e interesave te Shoqerise;
 - te pergatite dhe nenshkruaje pasqyrat financiare vjetore te Shoqerise, dhe raportin e ecurise se veprimtarise te cilat bashke me propozimin per shperndarjen e fitimit i paraqiten per miratim asamblese se pergjithshme te ortakeve.
 - te kryeje te gjitha regjistrimet dhe publikimet e detyrueshme ne lidhje me Shoqerine sipas parashikimeve te ligjit te zbatueshem;
 - t'i raportoje asamblese se pergjithshme te ortakeve ne lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe kryerjen e veprimtarive tregtare qe mund te konsiderohen me rendesi te vecante per Shoqerine;
 - te punesoje ose te nderprese marredheniet e punes me punonjesit sipas politikave te Shoqerise;
 - te kryeje detyra te tjera te percaktuara ne ligj dhe ne Statut.
- Administratori mund te ushtroje te gjitha kompetencat si dhe te kryeje te gjitha veprimet te cilat me ligj ose nga ky Statut tjeter nuk i rezervohen kompetencave te asamblese se ortakeve ose nuk kufizohen nga ky Statut apo nga ligji i zbatueshem.
- Administratori mund te delegoje pjeserisht ose teresisht kompetencat e tij tek persona te tjere te zgjedhur sipas gjykimit te tij.





Neni 14

Pergjegjesite e Administratorit

- Administratori per nje veprim te caktuar ne te cilin perfshihen interesa te tij ose te paleve te treta te lidhura me te, te cilat i kundervihen interesave te Shoqerise duhet te njoftoje asamblene e ortakeve si dhe mund te mos marre pjese ne vendimet qe lidhen me keto veprime.
- Administratori, kur personalisht apo permes paleve te lidhura me te ashtu sic percaktohen ne nenin 13 te ligjit 9901 me date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", kane interesa ne marreveshje te cilat do te lidhen nga Shoqeria duhet te njoftojne asamblene e ortakeve. Perfundimi i i nje marreveshje te tille duhet te miratohet nga asambleja e ortakeve.
- Administratori duhet te ushtroje detyrat e tij ne menyre te kujdesshme ne perputhje me kete Statut, ligjin e aplikueshem ne fuqi dhe vendimet e asamblese se ortakeve.

KREU V

VITI FINANCIAR-KONTROLLI KONTABEL-PRISHJA DHE LIKUJDIMI

Neni 15

Viti financiar dhe pasqyrat financiare

- Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 janar dhe mbyllet me 31 Dhjetor te çdo viti.
- Ne perfundim te çdo viti financiar, Administratori harton pasqyrat financiare ne perputhje me ligjin.

Neni 16

Fitimi dhe Dividentet

Fitimet qe rezultojne nga pasqyrat financiare te miratuara rregullisht, do te shperndahen midis ortakeve ne perputhje me kuotat e zoteruara, pervec rasteve kur eshte vendosur ndryshe nga ortaket ne mbledhjen e asamblese se pergjithshme ose nepermjet konsultimit me shkrim, ose do te perdoret per qellime te tjera sipas vendimit te asamblese se pergjithshme te ortakeve. Fitimi qe mund te shperndahet tek ortaket konsiston ne fitimin e vitit aktual, fitimin e realizuar ne vitet e kaluara dhe te mbartur, fitimi i realizuar ne vitet e kaluara i cili ishte destinuar per rezerven ligjore, kur qellimi i krijimit te rezerves eshte permbushur dhe ortaket vendosin te shfuqizojme rezerven ne fjale.

KREU VI

KONTROLLI KONTABEL

Neni 17

Kontrolli

Nese kerkohet nga ligji, eksperti dhe/ose ekspertet emerohen nga asambleja. Asambleja e ortakeve mund te riemeroje te njejtin/et ekspert/e. Eksperti/et shkarkohet/n nga detyra me vendim te asamblese se ortakeve ne rast mosrespektimi te detyres se tij, ne rast gabimi dhe ne rast mungese profesionalizmi ne sjellje.

KREU VII
PRISHJA DHE LIKUIDIMI

Neni 18

Prishja dhe Likuidimi

- Asambleja e ortakeve mund te vendose per prishjen e Shoqerise. Prishja e Shoqerise do te shoqerohet me likuidimin e saj.
- Shoqeria vazhdon te ekzistojte si person juridik vetem per nevoja te likuidimit deri ne perfundim te ketij procesi dhe gjate likuidimit togfjaleshi “ne likuidim e siper” duhet te vihet pas emrit te Shoqerise.
- Likuiduesi/t do te emerohet me vendim te Asamblese se ortakeve. Emerimi i likuiduesit/eve dhe procesi i likuidimit do te kryhen ne perputhje me dispozitat e ligjit shqiptar.


Neni 19

Ligji i Zbatueshem dhe Juridiksioni

- Per çeshtjet e parregulluara ne kete Statut do te zbatohet Ligji nr. 9901, date 14.04.2008 “Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare”, i ndryshuar.
- Çdo konflikt, divergjence, mosmarreshje apo pretendim i çfaredolloji, sidoqe te kete lindur nga apo ne lidhje me kete Statut, do t’i drejtohet dhe zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane. Ky Statut i Shoqerise u hartua ne kater kopje ne gjuhen shqipe, me te njejten vlere.

ORTAKET THEMELUES

Viktor PJETRI



Vasil KALLUPI



REPUBLIKA E SHQIPERISE



DHOMA E NOTERVE TIRANE

NOTERE

XHEVAHIRE BRAHAJ

Rruga "Ismail Qemali"

TIRANE

NR. 68 REP

VERTETIM NENSHKRIMI

Ne Tirane sot me date 25.10.2018, para meje noteres Xhevahire Brahaj, Notere e Dhomes se Noterise Tirane, me zyre ne adresen Rruga "Ismail Qemali", u paraqit personalisht;

- **Viktor PJETRI**, shtetas shqiptar, i datelindjes 10.03.1961, banues ne Tirane, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar, Identifikuar me pasaporte shqiptare numer personal G10310401G, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar ;
- **Vasil KALLUPI**, shtetas austriak, i datelindjes 01.01.1962, lindur ne Tirane dhe banues ne Viene, madhore dhe me zotesi juridike per te vepruar, me doukument identifikues karte identiteti austriake nr. DVR 0000191 dhe nr. 10890421, leshuar me date 16.04.2013 e vlefshme deri me date 15.04.2023, madhor dhe me zotesi te plote juridike per te vepruar.

Te cilet ne cilesine e ortakeve themelues, nenshkruajne me pranine time me vullnetin e tyre te lire dhe te plote Statuttin e shoqerise "**VA + NDREKAJ ENERGY & CONSTRUCTION GROUP**" .sh.p.k.

Une noterja vertetohet nenshkrimin e tyre konforme ligjit.

**NOTERE
XHEVAHIRE BRAHAJ**